

Republika e Shqipërisë
Dhoma e Noterisë Tiranë
Notere Elona L. Saliaj
Adresa: Blv. "B. Curri", Tiranë
Tel ++355 4 4324450
Nr 1065 Rep
Nr 382 Kol

Taksa e pullës u Likuidua

MARRËVESHJE SIGURUESE

Sot, më datë 14 Dhjetor 2016 (*dymjë e gjashtëmbëdhjetë*), para meje Noteres **Elona L. Saliaj**, anëtare e Dhomës së Noterisë Tiranë, me zyrë Noterie në Tiranë, Blv. "B. Curri", Pallatet "1 Maji", u paraqitën personalisht:

PALA BARRËMARRËSE/KREDITORI:

Shoqëria "ARC" Sh.p.k., person juridik, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të bizneseve me NIPT K81728025F, me seli në adresën: Rr. "Shemsie Haka", Kompleksi Matrix, Kati i Parë, Tiranë, përfaqësuar nga administrator **Alfons XHUVELI**, atësia Hamit, i datëlindjes 23.10.1972, lindur në Vlorë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me kartë identiteti me nr. personal H21023087I. (*këtu e më poshtë për efektet e kësaj kontrate i quajtur "Barrëmarrësi"*),

Dhe

PALA BARRËDHËNËSE:

Shoqëria "M & P – I" Sh.p.k., person juridik, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me NIPT L32026015L, me seli në adresën: Rr. "Ismail Qemali", Pallati Gener 2, Kati i I, Tiranë, përfaqësuar nga administratori **Redi PEZA**, atësia Daut, i datëlindjes 17.03.1981, lindur ne Tiranë, madhor me zotësi juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal I10317070O. (*këtu e më poshtë për efektet e kësaj kontrate i quajtur "Barrëdhënësi"*).

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përbajtj dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, bien dakord për të lidhur këtë *Marrveshje Siguruese* dhe kërkuan nga unë Noterja redaktimin e saj, në përputhje me ligjin, sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

NENI 1 PËRSHKRIMI I OBJEKTIT

1.1 Objekti i kësaj kontrate është krijimi i barrës siguruese mbi 40% të kuotave të shoqërisë **M & P - I Shpk** në pronësi të *Barrëdhënësit* si garanci për kontraten e huasë nr. 1064 Rep dhe nr. 381 kol., datë 14/12/2016, Notere Elona L. SALIAJ.

Opashky

NENI 2

KRIJIMI I BARRËS SIGURUESE

2.1 *Barrëdhënësi* vendos barrën siguruese mbi 40 % të kuotave të Shoqërisë “M & P – I” Sh.p.k (referuar në vijim si “**kolaterali**”), person juridik, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me NIPT L32026015L, me seli në adresën: Rrugë “Ismail Qemali”, Pallati Gener 2, Kati i I, Tiranë, me administrator **Z. Redi PEZA**.

2.2 Pronësia mbi kolateralin vërtetohet nga dokumentet bashkëlidhur kësaj kontrate dhe janë pjesë përbërëse të saj.

2.3 *Barrëdhënësi* siguron se lidhur me pronësinë e kolateralit, nuk ka pretendime nga palë të treta, ajo është tërësisht pronë e *Barrëdhënësit* dhe ai e barrëson atë të lirë nga çdo barrë apo të drejtë reale mbi të. Ky fakt vërtetohet edhe nga informacioni i marrë nga *Regjistri i Barrëve Siguruese Tiranë*, në rezultatet e kërkimit, sipas shkresës së dërguar nga *RBS*, bashkëngjitur kësaj kontrate.

2.4 Kjo marrëveshje siguruese do të depozitohet në *RBS* (*Regjistrin e Barrëve Siguruese*), me qëllim që pasuritë e vëna si kolateral të barrësohen në favor të *Barrëmarrësít*.

NENI 3

BAZA LIGJORE

3.1 Baza Ligjore e *Marrëveshjes Siguruese* është:

- Kodi Civil Shqiptar;
- Ligji nr. 8537, datë 18.10.1999 “Për barrët siguruese”, me ndryshimet;
- Ligji nr.7829 datë 01.06.1994 “Për Noterinë”, me ndryshimet.

NENI 4

KOMPLETIMI I BARRËS SIGURUESE

4.1 *Barrëdhënësi* autorizon *Barrëmarrësin* të regjistrojë formularët e njostimit të regjistrimit dhe dokumenta të tjera në *RBS* si dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet që ai gjykon se janë të nevojshme për të kompletuar dhe vazduhar kompletimin e Barrës Siguruese, për të mbrojtur dhe ruajtur Kolateralin dhe për të ekzekutuar barrën siguruese. Tarifa e regjistrimit do të paguhet nga *Barrëdhënësi*.

NENI 5

DETYRIMET E SIGURUARA NGA BARRA SIGURUESE

5.1 *Barrëdhënësi* siguron me kolateralin mbi të cilin është vendosur barra siguruese:

- (a) Pagimin e detyrimit sipas kontratës së Huasë nr. 1064 Rep., nr. 38 Kol., datë 14/12/2016.
- (b) Shlyerjen e të gjitha detyrimeve të tjera që sipas ndonjë shtojce të kësaj kontrate apo ndonjë marrëveshje të mëvonshme lidhen me kolateralin;
- (c) Pagimin e shpenzimeve për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe sigurimin e kolateralit;
- (d) Kryerjen e të gjitha veprimeve ligjore që burojnë nga aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë këto marrëdhënie.

NENI 6

VERIFIKIMI I KOLATERALIT

6.1 *Barrëmarrësi* ose personat e autorizuar prej tij kanë të drejtë të bëjnë inspektime dhe të verifikojnë kolateralin në çdo kohë dhe kohë pas kohe dhe *Barrëdhënësi* është dakord që të ofrojë

gjithë asistencën dhe informacionin e duhur mbi gjendjen ekzistuese apo kushtet dhe rrethanat që ndikojnë mbi të.

NENI 7 KOHËZGJATJA

7.1 Kjo marrëveshje siguruese mbetet në fuqi derisa të shlyhet plotësisht shuma e marrë hua, interesat dhe detyrimet e lidhura me të sipas kontratës së huasë nr. 104 rep dhe nr. 38/kol, datë 14/12/2016. Në rast të likuidimit nga ana e Huamarrësit e të gjithë vlerës monetare sipas përcaktimit të kontratës principale të huasë; *Marrëveshja siguruese* nuk ka më fuqi ligjore; prona e barrësuar do të lirohet dhe palët kthehen në gjendjen e mëparshme.

NENI 8

EKZEKUTIMI I BARRËS SIGURUESE

8.1 Në rast të mospërmbushjes së detyrimit të shprehur në nenin 5 të kësaj kontrate, Përfituesi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës dhe Zyrës së Përmbarimit për sekuestrimin e kolateralit objekt i kësaj marrëveshje dhe ekzekutimin e barrës siguruese apo kushtet dhe rrethanat që ndikojnë mbi të.

NENI 9

NDALIME QË KUFIZOJNË TË DREJTAT QË LINDIN NGA PRONËSIA

9.1 *Barrëdhënësi* nuk ka të drejtë të ndryshojë apo të krijojë të drejta pronësie ose të drejta të tjera reale mbi kolateralin, t'a përdorë atë si kolateral për detyrime të tjera të tashme apo të ardhme, të tijat apo të të tretëve pa marrë më parë pëlqimin me shkrim të *Barrëmarrësit*.

NENI 10

VAZHDIMËSIA E SIGURIMIT TË EKZEKUTIMIT TË DETYRIMIT

10.1 Në rast se kolaterali humbet, dëmtohet apo zhvleftësohet, *Barrëmarrësi* ka të drejtë të kërkojë garanci të plotë nga pasuri të tjera të *Barrëdhënësit*.

NENI 11

HYRJA NË FUQI

11.1 Kontrata hyn në fuqi dhe krijon pasoja juridike për palët kontraktuese në momentin e nënshkrimit prej tyre përpara Noterit dhe regjistrimit të kontratës me nr. Rep dhe Kol. në Regjistrin Notarial dhe do të ketë efekt deri në shlyerjen e plotë të detyrimeve të siguruara nga kolaterali mbi të cilin është vendosur barra siguruese.

11.2 Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së Marrëveshjes dhe në këndvështrimin e qëllimit që i shtyu palët të lidhin këtë Marrëveshje siguruese.

NENI 12

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM DHE JURIDIKSIONI, ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHEVE

12.1 Kjo Marrëveshje, është redaktuar në bazë të legjislacionit Shqiptar, Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe Ligjit “*Per barret siguruese*”, me ndryshimet. Për sa i përket çështjeve që kjo kontratë nuk i rregullon shprehimi, ato do të tregullohen nga dispozitat e tjera të Kodit Civil në fuqi.

12.2 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj kontrate midis dy palëve, do të zgjidhen me marrëveshje dhe mirëkuptim të ndërsjellët midis tyre në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi.

12.3 Kur midis palëve nuk arrihet zgjidhja e çështjeve me mirëkuptim, secila prej tyre mund t'i drejtohet për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Fier. (*Kompetenca Territoriale*)

12.4 Shtesa, ndryshime apo heqje dorë nga kjo Kontratë duhet të bëhen me shkresë dhe të nënshkruhen nga palët.

NENI 13 ANEKSET E KONTRATËS

13.1 Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të quhen Anekse të Kontratës:

- Ekstrakt i shoqërisë **M & P - I Shpk** për të vërtetuar pronësinë e kuotave,
- Vendim i asamblesë së shoqërisë "**M & P - I**" sh.p.k.
- Vendim i asamblesë së shoqërisë "**ARC**" sh.p.k.
- Dokumentet e identifikimit të palëve kontrktuese.

NENI 14 SHPENZIMET E KONTRATËS

14.1 Shpenzimet për përpilimin dhe redaktimin e Marrëveshjes Siguruese, shpenzimet noteriale dhe shpenzimet e tjera të lidhura me të, janë në ngarkim të *Barrëdhënësit*.

NENI 15 GJUHA E REDAKTIMIT TË KONTRATËS

15.1 Kontrata u redaktua në gjuhën shqipe prej meje Noteres në 4 (*katër*) kopje, e përbërë nga 5 (*pesë*) fletë secila, me vlera të njëjtë juridike; mbështetur në shprehjen e lirë e të plotë të vullnetit të palëve kontrktuese. Njëri ekzemplar vendoset në arshivën noteriale, një ekzemplar depozitohet në Regjistrin e barrëve siguruese për t'u bërë bllokimi i pasurisë në favor të Barrëmarrësit dhe ekzemplarët e tjerë u vihen në dispozicion respektivisht palëve kontrktuese.

NENI 16 DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

16.1 Marrëveshja siguruese, është redaktuar nga unë noterja në gjuhën Shqipe, në katër ekzemplarë me të njëjtën vlerë secila, u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të palëve kontrktuese, të cilët deklaruan se e kuptuan përbajtjen e saj dhe meqenëse ajo shpreh vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

16.2 Kjo Marrëveshje siguruese është redaktuar nga unë noterja në gjuhën Shqipe, e përbërë nga 3 ekzemplarë nga pesë faqe secila, me të njëjtën vlerë juridike secila.

16.3 Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përbajtjen e aktit notarial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 39 dhe 51 të ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994 "Për Noterinë", me ndryshimet; vërtetoj nënshkrimin e tyre në përputhje të plotë me ligjin.

16.4 Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj Kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

PALËT KONTRAKTUËSE

PALA BARRËMARRËSE/KREDITORI

"ARC Sh.p.k"

Administrator

Z. Alfons Xhuveli



PALA BARRËDHËNËSE

"M & P - I Shpk" shpk

Administrator

Z. Redi Peza



**NOTERE
ELONA L. SALIAJ**





EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	K81728025F	
2. Data e Regjistrimit	28/05/2008	
3. Emri i Subjektit	ARC	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	20/05/2008	
6. Kohëzgjatja	Nga: 20/05/2008 Deri:	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Rruga "Shemsi Haka", Pallati Matrix, kati i 1	
8. Kapitali	100.000,00	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	2,00	
9. Objekti i aktivitetit	Dhenia e konsulences, sherbime te marketingut dhe te promocionit ne fushen e tregtise si dhe realizimi i kontratave te shoqerive vendase me shoqeri te huaja. Veprimtari ne fushen e turizmit, hoteleri, bar -restorant etj. Sherbime logistike si (pa u kufizuar): Organizim i udhetimeve individuale dhe kolektive, rezervim hotelesh, sherbime guide, dhenie informacioni per udhetimet etj. Masterplane-studime e plane rajonale urbanistike, Plane irregulluese te përgjithshme per qendra te banuara ne qytete, Studime pjesore urbanistike, Projektim arkitektonik per objekte civile -industriale - turistike - vepra arti ne infrastrukturre, Projektim arkitektonik per objekte sportive, Projektim interiere, Projektim peisazhi, sistemim siperfaqe te "gjelberta, lulishte e parqe, Ndertime civile, industriale, turistike, buqesore deri ne 5 kate, Ndertime civile, industriale, turistike, buqesore mbi 5 kate - Rikonstruksione, Kruge kategoria V dhe VI, Ndertim ura dhe vepra arti deri ne 10 metra, Ndertim ujesjellesa te jashtem, kolektore shkarkimi, impiante vaditese, Ndertim ura dhe vepra arti deri 10 m, Ndertim ujesjellsa kanalizime, urbane rurale.	
10. Administratori/ët	Alfons Xhuveli	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 07/05/2015	Deri: 07/05/2020
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga		

Kopje



OKB

Centra e Komunikave e Aksioneve
National Business Center

parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	Arjan Leskaj	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 34.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	34,00	
- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)		
13. Ortakët	Besnik Leskaj	
13.1 Vlera e kapitalit	Para: 66.000,00	Natyre:
13.2 Numri i pjesëve	1,00	
13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	66,00	
- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)		
14. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	Tirane Tirane TIRANE Njesia Nr. 1, Rruga Shemsie Haka, Kompleksi Matrix, Zona Kadastrale 9290, Pasuria Nr. 3/262-N5	
15. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: ARC Telefon: 0692043712	
16. Statusi:	Aktiv	

Datë: 14/12/2016

Emri, Mbiemri, Nënshtkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	L32026015L
2. Data e Regjistrimit	26/08/2013
3. Emri i Subjektit	M & P - I
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	22/08/2013
6. Kohëzgjatja	Nga: 22/08/2013 Deri:
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Rruga Ismail Qemali, Pallati Gener 2, Kati I
8. Kapitali	100.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	2,00
9. Objekti i aktivitetit	<p>Ne ndertim: Projektimi dhe zbatimi i veprave ndertimore si vijon: ndertime me karakter civil dhe ekonomik, punime/germime dhe sistemime dhei, tarracime terrenesh, rikonstruksione godinash civile dhe ekonomike , veshje fasadash, ndertime urash dhe konstruksione metalike, montime panelesh, ndertime rrugesh, asfaltime kanalesh si dhe cdo ndertim tjeter me karakter civil dhe ekonomik. Prodhimin dhe tregimin me shumice e pakice, importin dhe eksportin e te gjitha llojeve te materialeve te ndertimit, brenda dhe jashtë vendit, per llogari te vete shoqerise si dhe te te tretave, ku perfshihen bojra per lyerje objektesh ndertimi apo bojra te te gjitha llojeve, inerte, gure, gure dekorative, gelqere, pllaka parafabrikate, llac cemento, rere dhe cdo material tjeter per ndertim.Projektimi dhe zbatimi i veprave ndertimore, rruge te te gjitha kategorive, punime te mirembajtjes dhe te sinjalizimit ne rruge, ndertim autostrade, pista aeroporte dhe helikoptere. Projektim dhe zbatim veprat, si ura, vepra arti mbi 10m, ndertim tunele rrugore dhe hekurudhere, ndertime detare ku perfshihen ndertime portuale, bankina, basen pontile, punime thellimi dhe drenimi, punime per vepra te vecanta e punime speciale, sillose, kulla uji etj. Projektimi dhe zbatimi i ndertimeve hidraulike dhe hidroteknicke ndertim ujesjelles, kanalizime, kanale dhe impiante vaditjeje. Punime mbrojtjeje te sistemit hidraulik, cimentime etj. Ndertim impiante te trajtimit te ujit,</p>

Kopje

	ndertim diga, galeri, tunele, ndertim digash te larta etj. Zhvillimi dhe ndermjetesimi i projekteve per rikonstrukcionin e ndermarrjeve industriale. Sigurimi i projekteve industriale ashtu si dhe strukturimi i kontratave afatgjata per levrime dhe mbi bazen e ketij rifinancimi dhe kreditimi. Ndermjetesimi, nxjerra dhe perpunimi i lendeve te para te te gjitha llojeve, veprimatari, sherbime etj. Kontraktimi me persona fizike dhe juridike vendas ose te huaj per gjetjen e tregjeve te shitjes per prodhimet dhe pune te shoqerise. Tregimi, importi dhe eksporti me shumice e pakice i te gjithe llojeve te prodhimeve industriale, ushqimore, konfeksione, veshimbathjeve, dhe te ngjashme me to, pajisjeve elektrike, elektroshtepiake, hidrosanitare, elektronike. Prova laboratorike.	
10. Administratori/ët	Redi Peza	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 22/08/2013	Deri: 22/08/2018
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	Bujar Huqi	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 20.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarra në përqindje (%)	20,00	
<i>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zoteron kuotën si përfaqësues)</i>		
13. Ortakët	Redi Peza	
13.1 Vlera e kapitalit	Para: 80.000,00	Natyre:
13.2 Numri i pjesëve	1,00	
13.3 Pjesëmarra në përqindje (%)	80,00	
<i>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zoteron kuotën si përfaqësues)</i>		
14. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit		
15. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: M & P - I Telefon: 0666031959	
16. Statusi:	Aktiv	



Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)



Kopje nga Web